



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Datë/a:	02.06.2021
Referenc-ë:	07-353/04-96202/21
Për/ Za/ To:	“KSDW”
Përmes/Preko/Through:	Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit
Nga/ Od/ From:	Punoi: Liridona Kastrati, zyrtare për hapësira publike Kontrolloi: Habib Qorri, udhëheqës i sektorit
Tema/ Subjekat/Subject:	Pëlqim

Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim ka pranuar kërkesën me nr protokollit 07-353/04-96202/21 nga “KSDW” për shfrytëzimin e hapësirës publike në hapësirën e amfiteatrit në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 5 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në ora 14:00. Qëllimi i kërkesë është shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Mjedisit ku do të mbahen aktivitete të ndryshme dedikuar fëmijëve si krijimi i terrariumeve së bashku me stafin organizativ, ndarja e mbeturinave në burim, krijimi i parqeve miniaturë.

Drejtoria pas shqyrtimit të kërkesës, duke u bazuar në nenin 4, pika 2, shkronjës i) të Rregullores për “Vendosjen, Ndërtimin dhe Largimin e Objekteve të Përkohshme në Pronën Publike” me nr.01-110-157481, jep pëlqimin për shfrytëzimin e hapësirës publike në hapësirën e amfiteatrit në sheshin “Zahir Pajaziti” me datë 5 Qershor 2021 nga ora 10:00 deri në ora 14:00 sipas kërkesës së parashtruar.

Kushtet e pëlqimit:

- Të respektohen të gjitha masat dhe rregullat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës për organizimin dhe mbajtjen e aktiviteteve publike;
- Varësisht nga vendimet e IKSHP-së dhe Ministrisë për parandalimin e përhapjes së pandemisë, kushtet e pëlqimit mund të ndryshohen apo të bëhet pezullimi.

Vërejtje: pala është e obliguar që të respektojë të gjitha pikat e cekura më lartë, në të kundërtën pëlqimi konsiderohet i pezulluar.